



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca plenare**

Seanca nr. 02-19/06-06

Prishtinë, më 24 mars 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e drejtoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 89 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendit i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE:**

1. Shqyrtimi i raportit të Grupit Negociator për rrjedhat e bisedimeve në Vjenë.

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe rendin e ditës së kësaj seance.

Në fillim të seancës, fjalën e morën këta deputetë:

**Fetah Berisha** kërkoi nga Grupi Negociator që në takimin e radhës në Vjenë të kërkojnë zbardhjen e fatit të pagjeturve dhe kthimin e kufomave nga Serbia. Ai shtoi se tani mbushen shtatë vjet nga masakra e regjimit të Serbisë në Krushë të Madhe, ku pati më se 207 veta të vrarë. Më 26 mars bëhet rivarrimi i 45 martirëve.

**Hydajet Hyseni** kërkoi që Qeveria t'i përgjigjet pyetjeve të deputetëve në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit, ngase ka kohë që ai ka parashtruar pyetje, por nuk ka marrë përgjigje. Meqë sot është 24 marsi, përvjetori i ndërhyrjes së Aleancës Veriatlantike në Kosovë, ai kërkoi që Kuvendi t'u shpreh mirënjohje dhe falënderime NATO-s dhe bashkësisë ndërkombëtare.

**Xhavit Haliti** tha se seanca e sotme është e papërgatitur, ngase nuk ka ndonjë raport me shkrim nga Grupi Negociator për takimet e Vjenës. Në Kuvend duhet të raportojë kryetari i Kosovës për rrjedhën e bisedimeve në Vjenë, ose ndonjë anëtar i caktuar nga Grupi Negociator, që e ka emëruar Kuvendi.

**Alush Gashi** tha se Forumi Rinor i LDK-së sot organizon një takim në hotelin Grand në shenjë përkujtimi të shtatë vjetorit të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë. Për takimet e Vjenës është dashur të ketë raport me shkrim, por edhe në mungesë të tij seanca të vazhdojë me debat. Për takimin e parë të raportojë ministri Lutfi Hairi, kurse për të dytin kryesuesi i atij takimi, Hashim Thaçi.

## **1. Shqyrtimi i raportit të Grupit Negociator për rrjedhat e bisedimeve në Vjenë**

**Kryetari** e ftoi kryesuesin e Delegacionit të Kosovës në takimin të parë në Vjenë të raportojë para deputetëve të Kuvendit për rrjedhën e bisedimeve.

**Zëvendëskryeministri Lutfi Haziri** tha se Delegacioni i Kosovës për status ka kërkuar nga unë që t'ju njoftoj në hollësi për rrjedhën e bisedimeve në Vjenë.

Bisedimet deri më tash kanë qenë të suksesshme dhe janë në rrugë të mirë të krijojnë hapësirë, ambient politik që Kosova të ecën drejt pavarësisë dhe rregullimit të statusit final.

Delegacioni punën e vetë e mbështetet në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës të 17 nëntorit 2005, si dhe në parimet themelore për reformimin e pushtetit lokal në Kosovë të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe do të vazhdojmë të ecim drejt realizimit të këtyre objektivave.

Parimet themelore, të miratuara nga delegacioni i Kosovës më 14 shkurt 2006, të elaboruara për reformën e pushtetit lokal janë të vlefshme dhe mund të zbatohen në tërësi vetëm në Kosovën e pavarur dhe sovranë.

Parimet për reformën e pushtetit lokal janë hartuar në përputhje me standardet e qeverisjes së mirë, të demokracisë, të transparencës e të sundimit të ligjit ashtu, siç zbatohen në mbarë Evropën.

Takimi në Vjenë i mbajtur më 20 dhe 21 shkurt 2006 kishte për temë kompetencat që do t'i kenë komunat në të ardhmen. Në përputhshmëri me parimet e dokumentit kornizë të Qeverisë së Kosovës dhe me parimet që u përmendën si substidialiteti dhe devolimi i

pushtetit, ne propozuam një serë kompetencash të ndryshme, duke u fokusuar këtu edhe në kompetencat e fushës së arsimit, të shëndetësisë, të kulturës, të planifikimi urban, të zhvillimi ekonomik lokal, të rinisë, të sportit dhe të aktivitete të tjera.

Angazhimet tona , me ndërmjetësimin e z. Rohan , që ka mandat të udhëheqë këto bisedime nga z. Ahtisari, kanë qenë të fokusuara në shëndetësinë primare dhe në atë sekondare, në mundësitë financiare , në nivelin qendror që ka kompetenca për udhëheqjen e koordinimit të përgjithshëm të politikave të shëndetësisë. Komunitatet të ofrojnë arsim parashkollor fillestar dhe sekondar, të drejtat gjuhësore, të drejtat për arsimim në gjuhën amtare, aty ku një grup etnik është pakicë. Komunitatet kanë përgjegjësi ta menaxhojnë arsimin dhe punësimin e arsimtarëve, duke përfshirë edhe pronën në arsim, serbët duhet ta kenë Universitetin në gjuhën e tyre. Po ashtu edhe pakicat tjera duhet të vazhdojnë të kenë arsimim të lartë. Në këtë kontekst u diskutua edhe për disa kompetenca të komunave të sferës së aktivitetit kulturor që të përfshihen teatrot komunale, aktivitete të ndryshme në kuadër të fushave që përfshijnë këto komuna. Të transferohet një pjesë e shërbimeve sociale në nivel komunash dhe, po ashtu, një nga diskutimet që është veçuar, ka të bëjë me çështjen e pensionistëve që është hequr nga agjenda e pushtetit lokal. Sa u përket policisë dhe drejtësisë është arritur pajtimi që nuk mund të ketë kompetenca komunale dhe që zinxhiri komandues të jetë i unifikuar, kështu që policia në komuna dhe të punësuarit në sistemin juridik në Kosovë , reflektojnë përbërjen etnike të komuniteteve.

Kjo është pjesa e parë e angazhimeve tona për takimin e parë. Ndërsa me vendim unanim të Delegacionit të Kosovës për status z. Hashim Thaçi është emëruar udhëheqës i Delegacionit për bisedime në Vjenë që u zhvilluan më 17 mars.

Takimi ishte i fokusuar në financat lokale, në bashkëpunimin ndërkomunal dhe ndërkufitar. Delegacioni potencoi se lidhur me ndihmat financiare për komunitatet, në sferën e kompetencave përkatëse, Kosova është e hapur për donacione ndërkombëtare, duke inkuadruar këtu edhe ndihma nga shtetet fqinje përfshirë edhe Serbinë. Të gjitha donacionet duhet të kalojnë nëpërmjet thesarit qendror dhe të jenë transparente dhe t'u nënshtrohen rregullave të përgjithshme të auditimit. Por nuk mund të ketë ndërhyrje në institucionet financiare të Kosovës. Ne sqaruam se pajtohemi për krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërkomunal në të gjitha fushat e pushtetit lokal. Mirëpo fuqimisht kemi potencuar se këta mekanizma në asnjë mënyrë nuk duhet të shndërrohen dhe në nivel të tretë të pushtetit dhe në asnjë etnitet të veçantë politik as juridik. Konstatuam që bashkëpunimi ndërkomunal duhet të rregullohet dhe të garantohet me kushtetutë dhe me Ligjin për qeverisjen lokale, që do të merrnin parasysh të gjitha standardet dhe përvojat më të mira evropiane dhe më gjerë

Takimi i ardhshëm do të mbahet më 3 prill, kurse Zyra e z. Ahtisari ,në ndërkohë,do ta hartojë dokumentin rreth parimeve të përbashkëta për pushtetin lokal në Kosovë.

Parimet e negociatave nuk kërkojnë që në këtë fazë të arrijmë marrëveshje për tema të veçanta. Nuk ka marrëveshje për asnjë element të pakos pa zgjidhjen e statusit përfundimtar, deri sa nuk është arritur marrëveshja për pakon në tërësi.

Pas raportimit të zëvendëskryeministrit, Lutfi Haziri për takimet e Vjenës, kryetari e hapi debatin.

**Emrush Xhemali (LPK)** propozues i mocionit për këtë temë, paraqiti një vështrim kritik për punën e Delegacionit të Kosovës në takimet e Vjenës. Në vazhdim ai tha se Delegacioni i Kosovës nuk u ka përmbajtur mandatit të dhënë nga Kuvendi, sepse ky delegacion nuk është dashur të bisedonte për organizimin e pushtetit lokal pa garanci për statusin e pushtetit qendror të Kosovës. Në këtë rast Serbia është e favorizuar në raport me vendet e tjera fqinje, që po ashtu, kanë popullsi pakicë dhe shumicë. Ai paraqiti pikëpamjet e PLK-së për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Në fund, propozoi që Kuvendit t'i miratonte këto propozime për Grupin Negociator: a) Bisedimet të jenë transparente e josekrete, b) Të mos diskutohet decentralizimi me Beogradin, c) Të mos lejohet pjesëmarrja e funksionarëve të lartë të Kosovës në anën e Delegacionit të Serbisë, por nëse ata dëshirojnë atëherë atyre duhet t'u ndërpritet mandati si dhe të ndërpritën financimi nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe nga organizatorët e bisedimeve të kërkohet garancion për statusin e ardhshëm të Kosovës.

**Xhylnaze Syla** - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së - tha se e përkrah punën e Grupit Negociator për reformimin e pushtetit lokal. Ajo shprehi shqetësimin për mos kontrollimin e tërë territorit të Kosovës nga Qeveria e Kosovës dhe kërkoi që Grupi Negociator, nëpërmjet Z. Ahtisari, t'i njoftojë Bashkësinë Ndërkombëtare dhe Serbinë se nuk do të ketë decentralizim të pushtetit lokal pa pasur garanci se tërë territori i Kosovës do të jetë nën kontrollin e Qeverisë së Kosovës.

**Sabri Hamiti** tha se Grupi Negociator në bisedimet e Vjenës duhet t'i mbrojtë interesat e vendit.

Anëtarët e Grupit Negociator për bisedime duhet të disiplinohen. Mosparaqitja në Kuvend e kryesuesit të Delegacionit në takimin e dytë, Hashim Thaçi, është i papërgjegjshëm.

Së pari duhet të zgjidhen problemet sistemore të Kosovës. Para se të decentralizohet pushteti lokal duhet organizuar pushtetin qendror të vendit.

Formimi i komunave të reja dhe financimi i tyre nga Beogradi, nuk janë probleme aq të lehta, siç i paraqiti zëvendëskryeministri.

**Jakup Krasniqi** - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së - tha se kryetari i Kosovës, si udhëheqës i Grupit Negociator, është dashur të raportonte në Kuvend për atë që është arritur në bisedime deri më tani.

Në Vjenë nuk po bisedohet për decentralizimin në tërësi, por vetëm për një pjesë të tij. Decentralizimi duhet të kryhet në tërësi, si çështje e brendshme e vendit dhe ai nuk duhet të diskutohet me askënd.

Dokumenti i paraqitur në Vjenë paraprakisht është dashur që të shqyrtohej në Kuvend.

**Teuta Sahatçija** tha se Grupi Parlamentar i ORA-s e mbështet punën e Grupit Negociator për bisedime në Vjenë. Ajo kërkoi nga Grupi Negociator që, përveç reformimit të pushtetit lokal, të shtrohet edhe çështja e personave të pagjetur.

**Xhezair Murati** - në emër të Grupit parlamentar 6+ tha se e mbështet punën e Grupit Negociator për bisedimet në Vjenë, por kërkoi nga Grupi që temat e diskutuara në Vjenë, paraprakisht të diskutohen në Kuvendin e Kosovës.

Bashkësia ndërkombëtare po merret vetëm me pakicën serbe, kurse po i anashkalon pakicat e tjera.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në lidhe me rrjedhën e bisedimeve të Vjenës dhanë këta deputetë: **Nekibe Kelmendi, Numan Baliq, Ramadan Kelmendi, Mazllun Kumnova, Mahir Yagcilar, Enver Hoxhaj, Xhevdet Neziraj, Qibrije Hoxha, Fadil Geci, Behxhet Brajshori, Hydajet Hyseni, Nazim Jashari, Besa Gaxheri, Ymer Muhaxheri, Xhevat Bislimi, Mark Krasniqi, Sabit Rrahmani dhe Xhavit Haliti**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, zëvendëskryeministri **Lutfi Haziri** iu përgjigj vërejtjeve dhe pyetjeve të deputetëve lidhur me bisedimet nga takimet e Vjenës.

**Kryetari** e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15:00.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

---

E hartoi:

**Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**